

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR
AKTIVITETIN:**

"KAPANON INDUSTRIAL 1 KATËSH"

*ME DESTINACION STACION TRANSFERIMI &
RIKUPERIM I MBETJEVE JO TË RREZIKSHME*

Vendodhja: Lagjia nr. 15, rruga "Miqësia"
kapanon 1-katësh, ZK 8517, me sipërfaqe
294.1 m², Bashkia Durrës, Qarku Durrës.

Kërkues: Subjekti: "CLEAN CITY" sh.p.k

Hartoi raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis:
"ENVIRONMENTAL MANAGERMENTS CONSULTANTS" Sh.p.k

Administrator
Elidiana Shehu



TABELA PËRMBLEDHËSE

1	TË PËRGJITHSHME	3
2	PËRSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	5
	TË PËRGJITHSHME	5
	LEGJISLACIONI	6
	PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR	7
3	PËRSHKRIM I PROJEKTIT	9
	QËLLIMI I PROJEKTIT	9
	TË DHËNA TEKNIKE TË AKTIVITETIT	9
	VENDODHJA E OBJEKTIT	9
	LIDHJA E OBJEKTIT ME INFRASTRUKTURËN INXHINIERIKE	11
	IDENTIFIKIMI I ZONAVE TË MBROJTURA/MONUMENTE KULTURE.....	11
	PËRSHKRIMI I PROCESEVE TEKNOLOGJIKE TË AKTIVITETIT	13
	STAFI I KËTIJ AKTIVITETI.....	15
	INFORMACION PËR SHKARKIMET NË MJEDIS	15
4	PËRSHKRIM I MJEDISIT TË RAJONIT	16
	TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....	16
	PËRSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE FIZIKE	16
	PËRSHKRIMI I FAKTORËVE KLIMATIK	16
	PËRSHKRIMI GJEOMORFOLOGJIK DHE SIZMIK I ZONËS.....	17
	<i>Gjeomorfologjia.....</i>	17
	<i>Sizmika.....</i>	17
	<i>Përshkrim i gjeologjisë së tokës në zonën e projektit.....</i>	17
	PËRSHKRIM I UJRAVE SIPËRFAQËSORE DHE NËNTOKËSORE NË ZONËN E PROJEKTIT	18
	<i>Ujërat sipërfaqësorë</i>	18
	<i>Ujërat nëntokësorë</i>	19
	PËRSHKRIMI I BIODIVERSITETIT NË ZONËN E PROJEKTIT.....	20
	<i>Përshkrim i habitateve kryesore në zonën e projektit, si dhe harta ilustruese</i>	20
	<i>Përshkrim i vegjetacionit, statusi i ruajtjes</i>	20
	6.6.3. <i>Përshkrimi i faunës, statusi i ruajtjes</i>	22
	Përshkrim i detajuar i llojeve faunistike të zonës në studim.....	22
	PËRSHKRIMI I CILËSISË SË MJEDISIT DHE NDIKIMEVE EKZISTUESE	23
	<i>Cilësia e ajrit në zonën e studiuar</i>	23
	Niveli i zhurmave në zonën e studiuar	26
	Administrimi i mbetjeve në zonën ku propozohet projekti	26
	PRESIONE KRYESORE TË MJEDISIT NË ZONËN E PROJEKTIT	27
	MJEDISI SOCIAL DHE EKONOMIK	27
	Përshkrimi i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti	27
	Njësia e qeverisjes vendore që administro zonën ku zbatohet projekti.....	28
	Popullsia dhe aktivitet kryesore ekonomike të zonës	29
	Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit.....	30
5	IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME NË MJEDIS	31
	METODIKA E PËRDORUR PËR VLERËSIMIN E NDIKIMEVE TË MUNDSHMENË MJEDIS.....	31
	VLERËSIMI I RËNDËSISË SË NDIKIMEVE TË IDENTIFIKUARA	32
6	PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTËSE.....	37
7	PROGRAMI MONITORIMIT	40
	QËLLIMET E MONITORIMIT MJEDISOR	40

1 TË PERGJITHSHME

Subjekti "Clean City" sh.p.k, është një subjekt privat i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit(QKR) me Numër Identifikimi (NIPT): L52223513S dhe seli në Durrës, Lagja 15, Rruga Miqësia, Kapanon1 katësh, Zona Kadatrale 8511, nr. pasurie 147/16 me përfaqësues ligjor Z. Gjergj Domi.

Subjekti "Clean City" sh.p.k kërkon të zhvillojë aktivitetin në adresën e Niptit Sekondar: **Lagjia 15, Rruga "Miqësia", Kapanon 1-Katësh, ZK 8517, Nr. Pasurie 283/3/ND, Bashkia Durrës, Qarku Durrës.**

Siperfaqia totale e pasurisë me emërtimin Objekti 1 katësh me sipërfaqe totale 294.1 m² (Ndërtesë 1-katëshe me sipërfaqe 145 m², e regjistruar në Pasurinë me Nr 283/3/ND, ZK 8517, se bashku me Ndërtesën me sipërfaqe 149.1 m², së bashku me ambientet rreth e qark e ndodhur në proces legalizimi sipas vërtetimit të lëshuar nga Aluizni Durrës me nr. 13651/1 Prot, datë 05.12.2018.)

Ky subjekt, si objekt të aktivitetit të tij ka veprimtaritë: pastrim, gjelbërim, grumbullim, transport, rikuperim i mbetjeve urbane, mbetjeve industriale si dhe rikuperimin dhe asgjësimin e tyre. Shërbim nëpër autoritetet portuale dhe subjekte të tjera, terheqjen e mbetjeve jo të rrezikshme, terheqjen dhe transportimin e mbetjeve të ndotura urbane dhe llumrat nga gropat septike. Grumbullim, transportim i të gjitha mbetjeve jo të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre drejt venddepozitimeve përfundimtare. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme, urbane, ambalazheve, ujrave të ndotura urbane dhe ujerave të gropave septike. Stacion transferimi të mbetjeve jo të rrezikshme.

Shoqëria "**Clean City**" sh.p.k është një subjekt i cili do zhvillojë aktivitetin e tij ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e Menaxhimit të integruar të mbetjeve jo të rrezikshme. Qëllimi i kompanisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave të cilësisë dhe menaxhimit të integruar të mbetjeve dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e transferimit dhe rikuperimit të mbetjeve.

Sipërfaqja ku do ushtrohet aktiviteti është në pronësi të Z. Ardian Tragaj, me të cilën shoqëria "Clean City" sh.p.k, ka lidhur kontratë Qiraje me datë 26.12.2018 per Objektin 1 katësh me sipërfaqe totale 294.1 m² (Ndërtesë 1-katëshe me sipërfaqe 145 m², e regjistruar në Pasurinë me Nr 283/3/ND, ZK 8517, se bashku me Ndërtesën me sipërfaqe 149.1 m², së bashku me ambientet rreth e qark e ndodhur në proces legalizimi sipas vërtetimit të lëshuar nga Aluizni Durrës me nr. 13651/1 Prot, datë 05.12.2018.)

Vendosja e këtij instalimi në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi nuk përbën shqetësim për banorët, ai ndodhet larg qendrave të banuara. Gjithashtu objekti i cili do përdoret për stacion transferimi dhe rikuperimit të mbetjeve jo të rrezikshme është i pasqyruar në certifikatën e pronësisë të permendur me lart. Ky aktivitet planifikohet të zhvillohet në zonën e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik Spitalë shpallur si e tillë me VKM nr. 262 datë 06.04.2016.

Kjo zonë shtrihet pranë qytetit të Durrësit, i dyti për nga zhvillimi ekonomik në Shqipëri, vetëm 30 km larg Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza" dhe 37 km nga kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana. Spitala është 6.4 km larg nga porti i Durrësit, i cili është më i madhi në vend dhe ka 4

terminale të dedikuara për transportin e mallrave. Ky pozicion si dhe ekzistenca e rrjetit rrugor e bën zonën shumë të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike.

Qëllimi i projektit të propozuar është që të shërbejë si stacion transferimi dhe rikuperimit për mbetje jo të rrezikshme . Stacioni i transferimit dhe rikuperimit do të shërbeje për depozitimin e përkohshëm të këtyre mbetjeve dhe më pas transportimin e tyre drejt operatorëve të licencuar për asgjësimin përfundimtar. Referuar Ligjit Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar operacionet që do të përdoren janë:

- **Shtojca 1 “Operacionet e asgjësimit”**

D15 Ruajtja/magazinimi në pritje të cilitdo prej operacioneve të renditura nga D 1 deri në D 14 (me përjashtim të ruajtjes paraprake në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

- **Shtojca 2 Operacionet e rikuperimit**

R 13 Ruajtja e mbetjeve në pritje të cilitdo nga operacionet e renditura nga R1 deri në R 12 (me përjashtim të ruajtjes paraprake, në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

Stacioni i transferimit dhe rikuperimit do të shërbejë për ruajtjen/magazinimin e përkohshëm të këtyre mbetjeve deri në asgjësimin – përdorimin përfundimtar të tyre nga operator të licencuar.



Ortofoto e zones ne vleresim

2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit të propozuar është që Kapanoni 1 katësh të shërbejë si stacion transferimi dhe rikuperimit për mbetje jo të rrezikshme të ngrurta dhe të lëngta, ku këto mbetje gjenerohen nga aktivitete të ndryshme në vendin tonë, në fushat: Mbetjet urbane; mbetje nga impjantet e trajtimit të mbetjeve, të ujrave të ndotura; mbetje të paspecifikuara; paketime mbeturinash; mbetje që dalin nga përpunimi i drurit. etj. Stacioni i transferimit dhe rikuperimit do të shërbejë për depozitimin e përkohshëm të këtyre mbetjeve, rikuperimin e një pjese të mbetjeve dhe më pas transportimin e tyre drejt operatorëve të licencuar për asgjësimin përfundimtar.

Referuar Ligjit Nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” i ndryshuar operacionet që do të përdoren janë:

Shtojca 1 “Operacionet e asgjësimit”

D15 Ruajtja/magazinimi në pritje të cilitdo prej operacioneve të renditura nga D 1 deri në D 14 (me përjashtim të ruajtjes paraprake në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

Shtojca 2 Operacionet e rikuperimit

R 13 Ruajtja e mbetjeve në pritje të cilitdo nga operacionet e renditura nga R1 deri në R 12 (me përjashtim të ruajtjes paraprake, në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).

Të dhëna teknike të aktivitetit


Subjekti “Clean City” sh.p.k, është një subjekt privat i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit(QKR) me Numër Identifikimi (NIPT): L52223513S dhe seli në Durrës, Lagja 15, Rruga Miqësia, Kapanon1 katësh, Zona Kadatrale 8511, nr. pasurie 147/16 me përfaqësues ligjor Z. Gjergj Domi.

Subjekti “Clean City” sh.p.k kërkon të zhvillojë aktivitetin në adresën e Niptit Sekondar: **Lagjia 15, Rruga “Miqësia”, Kapanon 1-Katësh, ZK 8517, Nr. Pasurie 283/3/ND, Bashkia Durrës, Qarku Durrës.** - Ndërtesë 1-katëshe me sipërfaqe 145 m², e regjistruar në Pasurinë me Nr 283/3/ND, ZK 8517 - Ndërtesë me sipërfaqe 149.1 m², së bashku me ambjentet rreth e qark e ndodhur në proces legalizimi sipas vërtetimit të lëshuar nga Aluizni Durrës me nr. 13651/1 Prot, datë 05.12.2018.


Subjekti, për realizimin e aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij. Ky aktivitet do zhvillohet në përputhje me planin e zhvillimit të zonës, ku kjo zonë është projektuar si zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik Spitallë.

Vendodhja e objektit


Aktiviteti në vlerësim ndodhet në **Lagjen 15, Rruga “Miqësia”, Kapanon 1-Katësh, ZK 8517, me sipërfaqe 294.1 m², Bashkia Durrës, Qarku Durrës.** Sheshi ku do zhvillohet aktiviteti në fjale ndodhet në zonën e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik Spitallë, e distancuar nga zonat e banuara, në një distancë prej rreth 800 m në vijë ajrore si nga ana lindore ashtu edhe nga ajo perëndimore. Në anën veriore kufizohet me rrugën “Miqësia” dhe më pas me biznes në një distancë prej 60 m, ndërsa në anën jugore kufizohet me toka të pa shfrytëzuara, tokë boshe (shih ortofoton mëposhtë:)



Distancat e sipërfaqes së aktivitetit nga zonat e banuara dhe bizneset



Harta treguese e pronës



Albanian 1986/Gauss-Kruger Zone 4

Pika	X	Y
A	4371719.86	4580591.03
B	4371750.40	4580608.14
C	4371755.06	4580599.81
D	4371724.53	4580582.70

Albanian 1986/Gauss-Kruger Zone 4

Pika	X	Y
E	4371750.40	4580608.14
F	4371794.02	4580632.57
G	4371799.23	4580623.28
H	4371755.60	4580598.84

Plan Rilevimi I pronës

Mbetjet të cilat nuk është e mundur t'i nënshtrohen procesit të riciklimit ose rikuperimit depozitohen në Vend Grumbullimin e Mbetjeve (VGM). Për sa i përket procesit të depozitimit final subjekti "Clean City sh.p.k ka aktualisht Akt - Marrëveshjen e lidhur midis Kompanisë dhe Bashkisë Durrës / Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale Durrës (NSHK), Nr. Prot 17 në datë **09.01.2019**, me objekt: Bashkëpunim i palëve për grumbullimin, transportin dhe depozitimin e mbetjeve në Vend Grumbullimin e Mbetjeve (VGM) të Bashkisë Durrës, administruar nga NSHK Durrës, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve për depozitimin e mbetjeve urbane dhe të ngurta jo të rrezikshme urbane të shoqërisë "Clean City" Sh.p.k.

Gjithashtu kompania Clean City sh.p.k ka aktualisht Akt - Marrëveshjen e lidhur midis Kompanisë dhe Ujesjellës Kanalizime Sh.a Durrës Nr. Prot 2104/1 në datë **17.10.2018**, që ka si objekt të punës së tyre grumbullimin dhe përpunimin e ujrave të zeza me objekt: Bashkëpunim i palëve për grumbullimin, transportim, dhe përpunimin e ujrave të zeza, me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve, për transportimin, grumbullim dhe përpunim i ujrave të zeza të shoqërisë "Clean City" Sh.p.k.

Nga proceset për ngarkimin – transportimi – shkarkimin e lëndës së parë mbetje jo të rrezikshme, nuk kemi gjenerim të ujrave të ndotura teknologjike pasi nuk zhvillohen procese të trajtimit dhe asgjësimit të tyre. Ujrat e vetme që mund të gjenerohen janë ato të reshjeve, të cilat do të grumbullohen në rrjetin e kanalizimeve të cilat do ndërtohen me beton/armë përgjatë sheshit të depozitimit. Këto ujëra do grumbullohen dhe orientohen në vaskën e dekantimit dhe seperatorin e ndarjes.

Sipëfaqja në të cilën do zhvillohet aktiviteti ka dalje direkt në rrugën "Miqësia e cila është në gjëndje shumë të mirë, e asfaltuar , rrugë e cila lidhet direkte me rrugën e re që është ndërtuar vitet e fundit e më pas me autostradën Tiranë-Durrës, e cila mundeson komunikimin e mëtejshëm me autostradën Durrës – Tiranë dhe nga ku mund të komunikosh me vendet e tjera të rajonit.

3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME NË MJEDIS

Metodika e përdorur për vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis

Çdo aktivitet që zhvillohet në mjedis shoqërohet me pasoja dhe ndikime në të, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jonë ka zgjedhur për t'u zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe më analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer. Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë bëhet duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur për ndërtim, mënyrën e funksionimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Bazuar në llojin e aktivitetit të propozuar ndikimet më thelbësore mund dhe duhet të analizohen sipas fazës:

- së funksionimit të aktivitetit.

Është e rëndësishme të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte ose indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve. Duke analizuar edhe shtrirjen në kohë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- Ndikime të kthyeshme në mjedis
- Ndikime të pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizim e proceseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- njohja me aktivitetin dhe fazat e zhvillimit të tij,
- njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis, njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes,
- konsultimi me dokumente ligjorë e administrative dhe raporte të VNM për veprimtari të njëjta.

Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuara

Për të përcaktuar më mirë masat për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identifikuara gjatë procesit të VNM-se dhe për të ndihmuar vendimmarrjen e organeve kompetente, në këtë paragraf është bërë një kategorizim i rëndësisë së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të projektit. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjislacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve funksionale të aktivitetit.

Ndikimet negative

Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Mjedisi është gjithmonë i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jete i ndryshem, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtpërdrejtë, të tërthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në njërën prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi sheshi është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm nga funksionimi i paisjeve dhe makinerive të stacionit të transferimit të mbetjeve dhe rikuperimit të tyre. Nuk marrin në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do vazhdojë të jetë i tillë dhe pas shumë kohësh. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

Efektet e mundshme nga aktiviteti që ushtrohet do të vlerësohen në mënyrë të përgjithshme në kërkesën për leje mjedisi tipi B. Megjithatë, shumë nga efektet e mundshme mund të identifikohen për arsye të eksperiencës nga nën-projektet e projektet e mëparshme në këtë fushë.

Impakti në mjedis i këtij impianti dhe menaxhimi i tij

Në vijim do të paraqesim një përmbledhje të efekteve negative mbi mjedisin të cilat lidhen me stacionin e transferimit dhe rikuperimit të mbetjeve jo të rrezikshme gjatë fazës operative së bashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Shkarkimet në ujë

Gjatë fazës së funksionimit të aktivitetit për transferimin dhe rikuperimit e mbetjeve, kemi ndikime të vogla në cilësinë e ujrave sipërfaqësore, pasi ujrat e shiut gjatë stinës së dimrit mund të ndikojnë në shpërlarjen e dherave. Projekti në fjalë nuk parashikon përdorim të ujit për zhvillimin e procesit për transferimin dhe rikuperimit e mbetjeve. Të vetmet ujra që mund të gjenerohen janë ato gjatë periudhës së reshjeve, të cilat mund të ndikojnë në shpërlarjen e mbetjeve dhe nëpërmjet rrjedhjeve të dëpërtojnë në ujrat sipërfaqësore e nëntokësore të zonës, si dhe në ndotjen e shtresave të tokës.

Emëtimet në ajër

Ndotja e ajrit vjen si rezultat i përhapjes së pluhurave që gjenerohen nga proceset e ngarkimit dhe shkarkimit të mbetjeve të transportit. Gjithashtu cilrimi i gazrave të lëndëve djegësë, që vijnë nga mjetet dhe makineritë e punës. Duhet theksuar se aktiviteti i përditshëm urban i automjeteve gjeneron ndotje më të madhe se sa përdorimi i mjeteve në sheshin ku do të zhvillohet aktiviteti. Duhet theksuar fakti se materiali që do të magazinohet përkohësisht në stacionin e transferimit dhe rikuperimit ka përmbajtje lagështie dhe densitet, gjë e cila e vështirëson mundësinë e përhapjes së grimcave të pluhurit.

Emetimet e zhurmave dhe gazeve të makinave të transportit në mjedis

Sa lidhet me emetimin e zhurmave gjatë procesit të transportit, duhet theksuar se ky ndikim është i minimizuar.

Ndikimet në tokë

Ndikimet në tokë do të jenë minimale, kjo për vetë faktin se punimet që do të realizohen për përgatitjen në sipërfaqen ku do zhvillohet aktiviteti stacion transferimi i mbetjeve dhe rikuperimit të tyre do të zhvillohen në sheshin e shtruar më parë me beton/armë, duke e përjashtuar në këtë mënyrë mundësinë e kontaminimit të tokës.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat që do të gjenerohen në mjedisin e sipërfaqes në fjalë, do të vijnë kryesisht nga mjetet dhe makineritë, si dhe nga përdorimi i vincave të ndryshëm, zhurmat e prodhuara nga vetë punonjësit që do të punojnë në aktivitet etj. Në rastet kur niveli i zhurmave i tejkalon normat kufi të zhurmës dhe përbën rrezik për punonjësit, atëherë do të përdoren masa mbrojtëse, në rastin konkret kufje.

Vlerësimet për zhvillimin e aktiviteteve të tilla, rezultojnë se nuk do të kemi gjenerim të zhurmës në nivele të larta dhe që mund të ndikojë në mjedisin e zonës përreth dhe punonjësit.

Objekti në fjalë ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zonat e banuara, duke mos ndikuar në aktivitetin e tyre të përditshëm. Puna në objekt do të jetë në orare të kufizuara vetëm kur do të kemi procese të depozitimit dhe transferimit të mbetjeve, procese të cilat nuk zgjasin më shumë se 30 minuta nga momenti i shkarkimit dhe ngarkimit të mjeteve të transportit.

Ndikimet në florë/faunë

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura dhe aktiviteti nuk ndikon në florën dhe faunën e zonës në fjalë, pasi kjo zonë është shumë e varfër me bimësi, gjithashtu zona ku do ushtrohet aktiviteti do të jetë e shtruar me beton/armë dhe me cakull, si dhe e rrethuar përgjatë gjithë perimetrit të sajë.

Mbetjet e prodhuara

Proceset që do të zhvillohen nga veprimtaria për transferimin dhe rikuperimit të mbetjeve jo të rrezikshme, nuk parashikojnë të gjenerojnë mbetje, pasi ky aktivitet konsiston pikërisht në menaxhimin e integruar të mbetjeve me anë të operacioneve D 15, dhe R 13, me qëllim ruajtjen përkohësisht të tyre dhe asgjësimin përfundimtar nga operatorë të licencuar.

Ndërsa mbetje që do të gjenerohen nga punonjësit janë mbetje urbane të cilat do të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore, gjithashtu duke parë infrastrukturën e dobët të menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën ku do të zhvillohet veprimtaria, shoqëria ka parashikuar instalimin e kontenierëve me qëllim diferencimin e mbetjeve që në burim.

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve

Toka / Përdorimi i Tokës

Kryerja e aktivitetit brënda sipërfaqes së kërkuar për zhvillimin e aktivitetit. Respektimi i kushteve teknike dhe standarteve.

Erozioni / Mbrojtja nga erozioni

Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e instalimit për ruajtjen/magazinimin transferimin dhe rikuperimin e mbetjeve. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave të shiut. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të sipërfaqes së objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirëmbajtja e bazamentit ku do të zhvillohet aktiviteti .

Biodiversiteti / Vegjetacioni, Dëmtim potencial i vegjetacionit

Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidanëve të rinj, kryesisht përgjatë rrugës që bën të mundur hyrjen për në objekt, si dhe në kufirin kufizues të pronës ku do zhvillohet aktiviteti.

Cilësia e ajrit / Rritje e emetimeve ne ajer nga funksionimi i instalimit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit

Mirëmbajtja e instalimeve dhe mjeteve të transportit sipas kapacitetit mbajtes. Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezervë brenda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i sipërfaqes së aktivitetit dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i stacionit të transferimit dhe rikuperimit, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.

Sistemi i drenazhimit

Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave teknologjike të gjeneruara nga pastrimi përgjatë gjithë gjatësisë së sipërfaqes së aktivitetit, bashkimi i tyre në një vaskë dekantimi , para se ato të derdhen në rrjetin e ujrave të zonës.

Mbetjet / Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në aktivitet.

Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësi vendore. Asgjesimi i mbetjeve që vijnë nga stacioni i transferimit dhe rikuperimit, nga kompani të licensuara.

Zhurmat / Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve

Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i stacionit të transferimit dhe rikuperimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjate orareve të përshtatshme.

Trafiku Rrugor / Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve

Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizin brenda normave të lejuara të shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

Ndjekja e gjithe kerkesave ligjore per venine ne funksion te aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve te treta.

- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambjent të mbyllur kështu që nuk do ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.
- Kompania ka ndertuar sistemin për rikuperimin e ujrave sanitare dhe ujrave të shiut.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Magazinim/ruajtje,rikuperim, transferim dhe asgjesim perfundimtar i mbetjeve nga subjekte të licensuara.

- Mbetjet e gjeneruara nga punonjesit do te grumbullohen ne kazan te vecante. Kazanet do te zbrazen rregullisht dhe mbetjet do te hidhen ne vendin e percaktuar nga Njesia Vendore per mbetjet urbane.
- Mbetjet e paketimit do te mblidhen dhe dorezohen ne kompani te licensuar per perdorimin, riciklimin apo trajtimin e tyre.
- Do te ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik ne pune si dhe pajisjes se punonjesve me uniformat dhe mjetet e nevojshme te mbrojtjes ne pune.
- Mbetjet urbane te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga Njesia Vendore.
- Te realizohet ndriçimi perreth (vendosja e impiantit te ndricimit).
- Te kryhet rregullimi i territorit ne perputhje me kondicionet urbane te percaktuara.
- Shoqeria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
- Te instalohen dhe te respektohen sinjalistikat e trafikut te cilat do te minimizonin impaktet per aksidente te mundshme.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20⁰⁰ e mbremjes deri ne 07⁰⁰ te mengjesit.
- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat ne Lejen e Mjedisit qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vleresimet e mesiperme, shkarkimet e pritshme ne mjedis jane te uleta dhe nuk perbejne problem serioz per mjedisin. Megjithë perparësite qe ka ky aktivitet, duhet te tregohet kujdes ne menaxhimin dhe mbajtjen nen kontroll te kushteve teknike per te minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.